


# NEWSLETTER E DIASPORËS



PERFAQËSIMI DHE NËXTITJA E POLITIKAVE TË BASHKËPUNIMIT DHE NDRËVEPRIMIT ME TË GJITHË SHQIPTARËT, DUKE NËXTUR E FUQIZUAR BASHKËPUNIMIN NË TË GJITHA FUSHAT ME SHQIPTARËT JASHTË KUFLJVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE SHITETET KU ATA BANOJNË

#115

## SAMITI/ Gruaja në biznes, sfida dhe arritje në kohë pandemie



Në Tiranë u mbajt këtë të enjte (8 korrik) Samiti i Gruas në Biznes. Takimi bëri bashkë, gra sipërmarrëse të Diasporës shqiptare dhe të vendit tonë, profesioniste të reja, gra akademike dhe eksperte në fushën e biznesit, përfaqësuese të institucioneve shtetërore dhe të organizatave ndërkombëtare, veçanërisht ato të cilat në programet e tyre kanë zhvilluar objektiva, lidhur me gratë dhe zhvillimin e tyre në fushën e biznesit dhe sipërmarrjes. Gjatë takimit u prezantuan eksperiencia dhe sfidave gjatë periudhës së pandemisë, si dhe përvoja dhe modele të suksesshme të grave sipërmarrëse. Gjithashtu, u diskutua për sigurimin e hapësirave dhe mundësive të investimeve të reja, krijimin e rrjetëzimit dhe nxitjen e bashkëpunimit mes tyre. Paneli i parë i Samitit të Gruas në Diasporë iu dedikua lidhshmërisë të gruas në biznes. Të pranishmit diskutuan mbi sfidat e pandemisë dhe përpjekjet e gruas për të ecur para në këtë biznes.



## "Apliko online për rinovimim e dokumenteve biometrike"

Shtetasit shqiptarë, që jetojnë jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë tashmë kanë mundësi të aplikojnë për rinovimin e dokumenteve të tyre biometrike, si dhe të deklarojnë adresën e tyre të vendbanimit online.

## GRATË NË BIZNES

### Ministri i Shtetit për Diasporën, z. Pandeli Majko: Gratë, një potencial i pashfrytëzuar

Në aktivitetin "Samiti i Grave të Biznesit", gjatë fjalës së tij përsëritëse, Ministri i Shtetit për Diasporën z. Pandeli Majko, foli mbi rolin e gruas në biznes dhe kontributin e tyre në Diasporë.

"Është shumë e thjeshtë të flasësh për politikë të re dhe marrëdhënie me diasporën dhe shumë e vështirë ta aplikosh atë në moment praktik, nganjëherë në këtë marrëdhënie të ndërlikuar arrin të kuptosh se puna në këtë drejtim i ngjan mbjelljes dhe rritjes së ullirit, duhet të punosh me ngulm e mendoj se për të pasur rezultate aktiviteti i samitit është një nga ngjarjet e veçanta që organizohen nga Dhoma e Biznesit të Diasporës dhe Fondi Shqiptar i Zhvillimit të Diasporës" tha ndër të tjera ministri Majko.



Është një platformë që synon të mbështesë e të nxisë transmetin e të dhënave profesionale duke ofruar një urë lidhëse me kapacitetet profesionet e ndryshme në Diasporë

## GRATË NË BIZNES/ Shtylla kurrizore e shoqërisë



"Sfidat e gruas sipërmarrëse të Diasporës në situatë pandemie", ishte tema mbi të cilën referuan panelistet në pjesën e dytë të takimit të cilat në fjalën e tyre theksuan rolin që ka guaja si shtylla kurrizore e shoqërisë. Në këtë panel folën Linda Dervishaj, përfaqësuese e AGA Academy, Pavlina Katiaj ka studiuar Ekonomi dhe Biznes në Greqi dhe ka punuar në disa kompani të mëdha, sot ajo drejton dy bizneset e saj private, njëri prej të cilave vazhdon ende të vuaj pasojat e pandemisë, Fitije Picari, drejtuese e Studio Picari në Itali, e cila solli eksperiencën e saj në shtetin fqinj. Në një ndërhyrje më pas Lavdrim Krashi u shpreh se do të paraqesë këtë kërkesë menjëherë sapo ti jepet mundësia e parë në parlament.



Connect Albania është një program që lehtëson angazhimin e Diasporës Shqiptare që jeton jashtë vendit në zhvillimin e vendit të tyre të lindjes si agentë zhvillimi për të tërhequr dhe rritur investimet midis komuniteteve shqiptare dhe të huaja përmes mekanizmit online

## MARRËVESHJA/ AKD dhe KOKSH, një Këshill Koordinues i Sportit në Diasporë

"Agjencia Kombëtare e Diasporës" dhe "Komiteti Olimpik Kombëtar Shqiptar" kanë nënshkruar sot një marrëveshje bashkëpunimi në vlerësim të qëllimeve të përbashkëta për të nxitur promovimin e sportit shqiptar në vendet pritëse të komuniteteve shqiptare në Diasporë. Arritjet e sportit shqiptar janë pjesë e identitetit kombëtar shqiptar duke përfaqësuar vendin tonë në aktivitete sportive ndërkombëtare. Qëllimi i kësaj marrëveshjeje, është krijimi i modelit të bashkëpunimit, midis "Agjencisë Kombëtare të Diasporës" dhe "Komitetit Olimpik Kombëtar Shqiptar", me qëllim promovimin, nxitjen dhe zhvillimin e aktiviteteve sportive të pjesëtarëve të Diasporës, ruajtjen e traditave sportive kombëtare kulturore, si dhe promovimin e shtrirjes së tyre. Ngritja e "Këshillit Koordinues të Sportit në Diasporë" është një ndër pikat e kësaj marrëveshjeje ku anëtarët e tij do të jenë sportistë të cilët gjatë karrierës së tyre kanë dhënë kontribut të çmuar në promovimin dhe zhvillimin e disiplinave të ndryshme të sportit shqiptar.



## Dijitalizimi i Veprave Shqiptare

Veprat e autorëve të letërsisë shqiptare vijnë për herë të parë në formatin digjital falas për të gjithë shqiptarët kudo që ndodhen

## TAKIMI/ I biri i Mitrush Kutelit dhuron botimet origjinale të të atit



Pak javë më parë Qendra e Botimeve për Diasporën finalizoi një nga projektet e saj më interesante, botimin e një prej veprave më të rëndësishme të kulturës tonë "Tregime të moçme shqiptare". Sfida më e madhe ishte përkthimi në pesë gjuhë të legendave shqiptare, e cila u realizua falë punës dhe profesionalizmit të pesë përkthyesve Andrea Grill (gjermanisht), Evelyne Noygus (frëngjisht), Eugenio Scalabrino (italisht), Ron Berisha, (anglisht) dhe Eleana Zhako (greqisht). Në shenjë falënderimi për vëmendjen kushtuar një prej penave me brilante shqiptare Mitrush Kutelit, dhe mundësinë e leximit të tij në pesë gjuhë dhe shpërndarjes së krijimtarisë në tij në diasporë, falë botimit në 5 gjuhë nga QBD, djali i tij Pandeli Pasko i ka dhuruar ministrit të shtetit për Diasporën Pandeli Majko dhe drejtoreshës së Qendrës së Botimeve për Diasporë Mimoza Hysa disa prej botimeve origjinale të Kutelit. Botime të realizuara përpara vitit 1944.

## Aplikacioni Gazeta "Diaspora Shqiptare"



App store: [këtu](#) Play store: [këtu](#)